Kronikë

# Lëviznin me armë pa leje nëpër Tiranë, arrestohen dy persona! U sekuestrohen 1 snajper dhe një pistoletë

*Vihen në pranga 2 shtetasit që i mbanin armët dhe sendet e kundërligjshme, në automjetin me të cilin qarkullonin dhe në banesat e tyre.*




*Momenti i arrestimit i njërit prej armëmbajtësve pa leje në Tiranë*

[Sh] .com Redaksia
26 Korrik, 11:19 | **Përditesimi i fundit: 26 Korrik, 11:20**

Vihen në pranga 2 shtetasit që i mbanin armët dhe sendet e kundërligjshme, në automjetin me të cilin qarkullonin dhe në banesat e tyre.

> *Njoftimi i policisë:*



LEXO EDHE:
***Aksident në Vorë, mjeti përplaset me motorin! Dy të plagosur***

> *Finalizohet, nga Komisariati i Policisë Nr. 1 dhe Forca e Posaçme "Shqiponja", operacioni policor i koduar "Double strike", për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje.*
>
> *Sekuestrohen 1 armë zjarri snajper, 1 armë zjarri pistoletë, një karikator arme automatike, 2 krehra pistolete, një sasi municioni luftarak, dy palë dylbi nate terminale dhe një dokument policie.*
>
> *Vihen në pranga 2 shtetasit që i mbanin armët dhe sendet e kundërligjshme, në automjetin me të cilin qarkullonin dhe në banesat e tyre.*
>
> *Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 1, në bashkëpunim me shërbimet e Forcës së Posaçme "Shqiponja", në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e armëmbajtjes pa leje, bazuar dhe në informacionet e siguruara në rrugë operative se në afërsi të rrethrrotullimit të Sanatoriumit, me një automjet, po qarkullonin 2 shtetas të armatosur, kanë organizuar punën dhe kanë finalizuar me sukses operacionin policor të koduar "Double strike".*
>
> *Si rezultat i këtij operacioni, u bë kapja dhe arrestimi në flagrancë i shtetasve:*
>
> *- R. R., 39 vjeç, banues në Tiranë;*
>
> *- E. H., 28 vjeç, banues në Laknas, me precedent të mëparshëm penal në fushën e vjedhjes.*
>
> *Gjatë kontrollit në automjetin me drejtues shtetasin R. R. dhe pasagjer shtetasin E. H., shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, një armë zjarri snajper, targa të huaja, një mjet identifikimi ai ato të Policisë dhe një pult për hapjen dhe mbylljen e targave të mjetit.*
>
> *Në vijim të kontrollit, në banesat e këtyre shtetasve, u gjetën një armë zjarri pistoletë, dy palë dylbi dhe municion luftarak, të cilat u sekuestruan, në cilësinë e provës materiale, së bashku me automjetin.*
>
> *Materialet i kaluan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme procedurale, për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit" dhe "Mbajtja pa të drejtë e uniformës".*

Në përditësim ....

G.MO/Shqiptarja.com

**TAG:** arrestohen Tirane

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

**Sondazhi i ditës:**
**Ndërrimi i emrit të LSI në Partia e Lirisë nga Ilir Meta sjell:**

Vizion të ri | Asgjë të re | Nuk e di

## Lajme të tjera

Kronikë

Ekstradohet nga Britania drejt Shqipërisë i shumëkërkuari me 3 identitete! I dënuar me 21 vite burg për vrasje
25 Korrik, 15:46

Kronikë

Paskuqan, punimet për pallatin dëmtojnë shtëpitë! Banorët: Firma na kërkoi të heshtim! Na thonë flini në hotel (VIDEO)
Enxhi Musaj
25 Korrik, 11:48

Kronikë

I vodhën me dhunë varësen e floririt vajzës në Tiranë dhe më pas e shitën në argjendarinë Lezhë, arrestohen dy autorët (VIDEO)
25 Korrik, 09:10

Politikë

Terminali i ri Lindor i Tiranës do të jetë gati në shtator, Rama: Pikë lidhje ndërmjet transportit urban, ndërqytetas dhe atij ndërkombëtar
25 Korrik, 09:09

Kronikë

Kundër rregullave të parakalimit, 'Droni edukues' kap në shkelje shoferët në Tiranë (VIDEO)
24 Korrik, 14:58

Sociale

Veliaj inspekton Terminalin Lindor të Tiranës: Kemi vendosur standardin e një stacioni modern udhëtarësh! Së shpejti nis puna për terminalin verior
24 Korrik, 12:00

Politikë

Veliaj nga Njësia 5: PS punon edhe për emigrantët jashtë vendit, që mezi presin të legalizojnë mundin e djersën
23 Korrik, 20:48

Kronikë

Kavajë/ Rrezikonte të mbytej, shpëtohet 10 vjeçari në plazhin e Spillesë
23 Korrik, 18:21

Sociale

Tirana koncert për hapjen e negociatave me BE dhe 100-vjetorin e marrëdhënieve SHBA-Shqipëri, Veliaj fton qytetarët më 28 Korrik: Një vit fantastik
23 Korrik, 16:08

Politikë

Zgjedhjet 2023/ Fatbardh Kadilli shpall kandidaturën për Bashkinë e Tiranës: Do bashkoj çdo thërrime opozitarizmi
23 Korrik, 08:30

Kronikë

Gjendet fëmija 5-vjeçar në Tiranë, u largua nga gjyshja në zonën e Brrylit
21 Korrik, 20:35

Sociale

Koncert festiv për 65-vjetorin e Organizatës së Veteranëve, Veliaj: Shqipëria zgjodhi anën e duhur të historisë
21 Korrik, 12:45




RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton



© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje